

MOS JU AFRO UDHËHEQËSVE TIRANË!

Ruaju mirë nga hyrja në oborret e udhëheqësve zullumqarë, nga shkelja në pallatet e tyre dhe të qenurit i afërt me ta, ngase Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Assesi mos u bë i afërt me ta! Kush i aprovon rrenat e tyre dhe u ndihmon në padrejtësitë që i bëjnë, s’është prej mua e as që unë jam prej tij. Ky person në botën tjetër s’mund të vijë në krye të Havdit. Ai që afrohet me ta, por nuk ua aprovon rrenat dhe s’u ndihmon në padrejtësitë e tyre, është prej mua dhe unë jam prej tij. Ky person në botën tjetër do të jetë në krye të Havdit.”* *“Dëshmorët më të lartë janë Hamza bin Abdulmuttalib dhe ai që prijësin tiran e urdhëron për punë të mira dhe e ndalon nga e shtrembëra dhe e gabuara.”*

MOS E NËNÇMO ASNJË DHUNTI TË ALL-LLAHUT!

Sa më pak hyn në shtëpitë dhe pallatet e parisë së ndonjë shoqërie që është thelluar në bollëk dhe që veten ia ka dorëzuar kënaqësive epshore, sepse hyrja te ta do të çojë që të mahnitësh nga stolitë dhe pasuritë e tyre dhe t’i zvogëlojë në syrin tënd dhuntitë e mëdha të All-llahut, i Cili Pejgamberin (s.a.v.s.) e urdhëron: *“Dhe mos i hidh sytë me lakmi për gjërat të cilat Ne ua kemi dhënë disave prej tyre për kënaqësi të shkëlqimit (të përkohshëm) të jetës së kësaj bote me qëllim që ne të mund t’i provojmë me ta, por shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i vazhdueshëm.”* (Taha, 131)

Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Shikoje atë që (nga të mirat e kësaj bote) është në shkallë më të ulët se ti! Kjo do të ndihmojë që të mos i nënçmohesh dhuntitë që t’i ka falë i Lartmadhëruari.”* Jahja bin Muadhi ka thënë: *“Dunjaja është një hiç. S’ia vlen as dëshpërimi për një çast. Kur e di se pjesa yte e kësaj bote është e paktë, pse atëherë tërë jetën dëshpërohesh?”*

KËRKOJE DHE GJEJE MË TË MIRËN PËR TY!

Sehl bin Abdullahu ka thënë: *“Koha është gjëja më e shtrenjtë që ke. Plotësoje atë me gjëra të çmuara si ajo!”* Disa njerëz të urtë janë shprehur kështu: *“Gjërat më të shtrenjta që ke janë zemra dhe koha. Ke kujdes ndaj tyre!”* Braktise çdo fjalë, vepër dhe lëvizje që s’të intereson, sepse Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Nga Islami i bukur i njeriut është mosmarja me gjërat që nuk i përkasin atij (interesojnë!)”*

BËHU I SINQERTË NË BESIM DHE SJELLJE!

Përqafoje sinqeritetin në çdo vepër e adhurim. All-llahu (subhanehu ve teala) ka thënë: *“Ata nuk u urdhëruan për tjetër, veçse ajo që duhet të adhuronin vetëm All-llahun dhe të mos adhuronin tjetër përveç a përkrah Tij, të adhuronin Atë me besim të vërtetë e me përkushtim të plotë...”* (El-Bejjine, 98). Pejgamberi (s.a.v.s.) mes tjerash ka porositur sinqeritetin dhe dëlirësinë: *“Kryeje ibadetin me përkushtim e sin-*

qeritet! Të mjafton edhe e pakta nga ibadeti i kryer në këtë mënyrë.” Bëhu i ndershëm e besnik në të gjitha punët, sepse të ka shkuar kot çdo moment në të cilin nuk ke vepruar me drejtësi. All-llahu thotë: *“Nga besimtarët ka njerëz që e mbajtën me të vërtetë besën me All-llahun...”* (El-Ahzab, 23). Pejgamberi (s.a.v.s.) lidhur me ndershmërinë (sidk) ka thënë: *“Ndershmëria shpie në mirësi.”*

VAZHDIMISHT KËRKO FALJE PREJ ALL-LLAHUT!

Mendo rreth mëkateve të bëra! Mendo rreth veprave të shëmtuara që ke kryer dhe kaloi ato nëpër kokë. Drejtohu Zotit me ndjenjë të pendimit të plotë për veprat e këqia të bëra dhe lute Atë për falje. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Personi që pendohet, është sikur ai që nuk bën gjynahe.”*

DHËNIA PAS KËSAJ JETE ME KËNDJE

Pakësoi kontaktet me ata që me këndje janë të dhënë pas kësaj bote, sepse këta njerëz bëhen shkaktarë që edhe ti të jipesh pas kësaj bote për së tepërmi dhe duke u dhënë përparësi gjërave materiale të qëndrosh larg All-llahut: *“Dijeni se jeta e kësaj bote është vetëm lojë, qejf, salltanat dhe mburrje e ndërsjellë mes jush dhe rivalitet për pasuri e fëmijë...”* (El-Hadid, 20). Shoqërohu me njerëz që e kanë nxjerrë prej zemrës dashurinë ndaj dynjasë dhe që s’i japin rëndësi asaj! Miqësohu me njerëz që i kanë lënë mënjane zbavitjet dhe qejfet e kësaj bote dhe që i japin përparësi ahiretit. *“Kushdo që dëshiron për gjërat kalimtare (të kënaqësive të kësaj bote), Ne ia japim atij menjëherë çfarë ne duam dhe për kë Ne duam. Pastaj mbas kësaj ne kemi përcaktuar për të Xhehennemin, aty do të digjet i përçmuar dhe i flakur tej. Dhe kushdo që dëshiron jetën e fundit, përpigjet dhe i shërben asaj me mundin që duhet për të duke qenë besimtar, atëherë të tillët janë ata përpjekja e të cilëve do të jetë e pëlqyer.”* (El-Isra’, 18, 19)

All-llahu na lajmëron se venbanimi i përhershëm i atyre që vrapojnë pas kënaqësive kalimtare dhe që me ashk lidhen pas kësaj bote do të jetë Xhehennemi. Përkundër kësaj, na lajmëron se me shpërblimet më të mira do t’i shpërblejë ata që synojnë bukurinë e botës së pastajme dhe që të bindur punojnë për të. Xhenneti arrihet me përpjekje, orientim kah All-llahu, qëndrim në këmbë duke bërë ibadet dhe të dëshiruarit atë me të cilën është i kënaqur Ai. All-llahu i çmon këta njerëz dhe u dhuron bukuri përtej shpresave të tyre. Kjo bukuri do të thotë qëndrimi i Tij afër këtyre robërve dhe dhënia mundësi për ta parë Lartmadhërinë e Tij: *“Me të vërtetë që të përkushtuarit (në besimin e pastër islam) do të jenë ndër kopshte të begatë dhe lumenj. Në kuvendin e së vërtetës pranë Mbisunduesit Fuqiplotë.”* (Eel-Kamer, 54-55)

“Disa fytyra atë Ditë do të jenë që shkëlqejnë, duke parë Zotin e tyre.” (El-Kijame, 22-23)

Jetës së kësaj bote mos i jep rëndësi më tepër nevojave tua, përndryshe të pengon nga nënshtrimi dhe adhurimi ndaj Zotit. Nga pasuria e kësaj bote të mjafton aq sa ta mundësh urinë dhe t’i mbulosh pjesët e turpit. Të mjaftojnë një shtëpi për banim, një copë bukë dhe uji.

SILLU MIRË ME PRINDËRIT DHE MOS I NDËRPRIT MARRËDHËNIET ME FAREFISIN!

Ndero prindërit dhe bëhu bamirës ndaj tyre. All-llahu hakun e vet e përmend bashkë me hakun e nënës dhe babës: *“Më falënderoni Mua dhe prindërit tuaj, tek Unë është kthimi i fundit!”* (Lukman, 14)

Është pyetur Muhammedi (alejhi’s-selam): *“Kush meriton më së tepërmi mirësjelljen e respektin tim?”* Pejgamberi është përgjigjur: *“Nëna!”* E pas saj? Ai prapë është përgjigjur: *“Nëna!”* Për së treti është pyetur: *“E më pas?”* Prapë është përgjigjur: *“Nëna!”* Për të katërtën herë ka thënë: *“Babai dhe mëturja farefis tjetër sipas shkallës së afërsisë.”*

Në subjektin e marrëdhënieve farefisnore Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Fjala rahm (farefisi) është e lidhur me fjalën Rrahman (i Gjithmëshirshmi). All-llahu ka thënë: Kush i ruan lidhjet me ty edhe unë i ruaj lidhjet me të. Kush i ndërpret lidhjet me ty edhe unë i ndërpres lidhjet me të.”*

RESPEKTOI FQINJËT!

Çmoi fqinjët tu dhe kalo mirë me ta, sepse Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Xhibrili aq shumë më këshilloi për fqiu sa që mendova ses do ta bëjë trashëgues timin.”*

Mos e kurse ndihmën për fqiu që ka nevojë. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë se *“All-llahu i ndihmon besimtarit përderisa ai i ndihmon vëllait të vet musliman që ka nevojë për ndihmë.”*

MËSOI DHE APLIKOI RREGULLAT E MIRËSJELLJES!

Mos e nxjerr në shesh asnjë të metë të muslimanit, sepse Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Kush ia mbulon të metat vëlrat të vet musliman, All-llahu do t’ia mbulojë atij të metat në dynja dhe ahiret.”* Mos i ndërprit lidhjet edhe me personin që shikëputet prej teje. Bëji mirë atij që të bën keq. Duro ndaj atij që të bën padrejtësi dhe fale. Mos u bëj ziliqar ndaj të tjerëve për çështje të kësaj bote, sepse Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Mos u bëni ziliqarë ndaj njëri-tjetrit!”* Andaj respektoi pleqtë dhe mëshiroi fëmijët! *“Ai që nuk i mëshiron të vegjëlit dhe që nuk i respekton pleqtë tanë nuk është prej nesh.”*

MOS U NDAJ NGA MIRËSJELLJA!

I Dërguari i Zotit ka thënë: *“Turpi është prej besimit!”* *“Turpi në tërësi është mirësi.”*; *“Dhe mos i kthe prapa ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje duke kërkuar Fytyrën e Tij.”* (El-En’am, 52). Trego madhështi edhe ndaj të pasurit që e sheh veten të vetëmjaftueshëm dhe konsideron se nuk ka nevojë për Zotin. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: *“Pasanikut*

falënderues i shkruhen sevape sa të varfërit durimtar.”

Në çdo çështje personale dhe të përgjithsme konsultoi njerëzit që i frikohen All-llahut dhe kanë takva. I Lartmadheruari e ka urdhëruar Muhammedin (s.a.v.s.) që të konsultohet me ashabët e tij: **“Dhe këshillohu me ta për punët.”** (Al-i Imran, 159). Pas konsultimit të bërë, kur të vendosësh mbështetu vetëm te All-llahu: **“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu te All-llahu, se Ai me të vërtetë, i don ata që i mbështetin shpresat vetëm tek Ai.”** (Ali Imran, 159)

BËHU I SJELLSHËM!

Bëhu i mirë ndaj shokëve e miqve. Bëja rregull vetes sjelljen e mirë dhe dashamirësinë. Transmetohet se Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Toleranca dhe butësia e zbukurojnë çdo gjë. Injoranca dhe torollakllëku e shëmtojnë çdo gjë.”**

Një ditë Ebu Bekri (r.a.) kishte bërë me shenjë kah gjuha dhe i kishte këshilluar ata që ishin prezentë: **“Ja kjo është ajo që më shkatërroi!”**

RESPEKTOE TË DREJTËN E NJERËZVE!

Mbroje veshin nga të dëgjuarit e rrenës, përgojimit, shpifjës dhe gjërave të padobishme: **“Me të vërtetë që të dëgjuarit, të shikuarit dhe zemra, secila prej tyre do të pyetet.”** (El-Isra’, 36). Vazhdo të pendohesh në çdo moment duke iu drejtuar All-llahut me ndjenjë të plotë të pendimit. I Dërguari i Zotit ka thënë: **“Me të vërtetë unë brenda ditës pendohem njëqind herë.”**

GJITHMONË PËRKUJTOE DHE PËRMEDE ALL-LLAHUN!

Ruaju nga ngrënia e gjërave të ndaluara dhe të dyshimita dhe nga ulja në sofrat e atyre që veprojnë në kundërshtim me urdhërat e All-llahut. Në veçanti, në asnjë mënyrë mos u ul në sofrat e udhëheqësve tiranë dhe të ndihmësve të tyre. Çdo trup që zhvillohet me fitim jolegjitim më tepër e meriton Zjarrin.

Muhammedi (s.a.v.s.) e ka ndaluar përgjigjen ftesave të mëkatarëve dhe ngrënien e ushqimit të tyre.

Dije se All-llahu të kontrollon në çdo gjendje e vepër, madje edhe në çastet kur je i vetmuar: **“Sigurisht All-llahu është kurdoherë Gjithëvëzhgues.”** (En-Nisa’, 1)

Trego vazhdimësi në përkujtimin dhe të përmendurit e All-llahut. Përmendja yte të Madhin Zot mundëson që edhe Ai të të përmend ty. I Lartmadheruari thotë: **“Kështu pra, më kujtoni Mua, (që) unë t’ju kujtoj ju...”** (el-Bekare, 152)

Në një hadith kudsii thuhet: **“All-llahu ka thënë: Personit të cilin përmendja e emrit Tim e ndalon nga të kërkuarit nga Unë plotësimin e nevojave, do t’i jap më tepër sesa atyre që kërkojnë.”**

KËSHILLOE ÇDO NJERI!

Pakësoje qeshjen! Muhammedi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Të qeshurit e shumtë e mbyt zemrën.”** Vdekjen gjithmonë shikojë

si të afërt, kurse plotësimin e dëshirave si një gjë të largët. Kjo do të ndihmojë të bësh vepra të mira. All-llahu lidhur me mohuesit e të vërtetës thotë: **“I lini vetëm ata të hanë e të shijojnë (të mirat e përkohshme të kësaj bote) si dhe t’i përkushohen shpresës së kotë.”** (El-Hixhr, 3)

Pandërprerë këshilloi njerëzit! Nga sahabët, Xherir bin Abdullahu thotë: **“Ja dhash besën të Dërguarit të Zotit se do ta këshilloj çdo musliman.”**

FJALA E FUNDIT

Trego vazhdimësi në këto:

- * Edukoe veten duke e kundërshtuar nefsin.
- * Ushqehu me rizk hallall!
- * Ruaje syrin prej harameve dhe gjërave të dyshimita!
- * Ruaje gjuhën prej fjalëve të fëlliqura.
- * Zemrën mbaje vazhdimisht nën mbikëqyrje.
- * Ruaji sekretet!
- * Trego dhembshuri ndaj krijesave!
- * Këshilloje çdokënd!
- * Për t’i arritur këto shkallë vazhdimisht lute All-llahun!
- * Gjithmonë qortoje nefsin dhe për të ushqe mendim të keq, kurse për njerëzit mendim të mirë!

- * Dashuroi dhe respektoi të devotshmit!
- * Bëju mirë dhe ndihmoju të varfërve.
- * Përpiqu që të zotërosh virtyte të këtilla të larta!

All-llahu të ndihmoftë që ta respektosh Lartmadhërinë e Tij! Dije mirë se duke t’i porositur këto gjëra, nuk njoh njeri që më tepër se unë ka nevojë për to. Njeriu më fatzi është ai që i këshillon të tjerët ndërsa për vete nuk merr mësim. E lus All-llahun që t’i largojë perdet e gafletit dhe dyshimit.

Duke të lënë nën mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e All-llahut, të porosis që t’i lutesh Atij që të ma pranojë pendimin. Ndoshta në saje të kësaj lutjeje ma pranon atë. Ai ka fuqi për një gjë të tillë. Të gjitha falënderimet i takojnë vetëm Zotit të botëve. Zoti im prano! Amin!

Shkëputur nga: TË METAT E NEFSIT

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtin. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur’anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

On-line versionin e këtij teksti mund ta gjeni në: <http://www.albislam.com/>



Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 223-654
1000, Shkup

Porosia ime për të riun

Vëlla! Të porosis ty dhe veten për takva (frikërespekt-dashuri) tek All-llahu. All-llahu të ndihmoftë në mënyrë më të mirë për të arritur këtë sukses! Takvaja i mbulon të gjitha dëshpërimet. Nëse ruhesh prej njerëzve, dije se ata s’mund të të sjellin kurrfarë dobie para të Gjithfuqishmit, i Cili thotë: **“...dhe kushdo që ka frikë All-llahun dhe plotëson detyrimin ndaj Tij, Ai do t’ia bëjë atij çështjen të lehtë.”** (Et-Talak, 5)

Të porosis që ta ndjekësh rrugën e respektimit dhe adhurimit të All-llahut. Asnjëherë mos e kundërshto Atë! Për çdo problem drejtohu kah Ai me tërë zemrën: **“Dhe kushdo që mbështetet e vë shpresat tek All-llahu, atëherë Ai do t’i mjaftojë atij plotësisht.”** (Et-Talak, 3)

Disa nga dijetarët kanë thënë: **“Kërkimi i ndihmës së një krijese nga një krijesë tjetër i përngjan kërkimit të ndihmës së një të burgosuri nga një i burgosur tjetër.”**

Mendo mirë! Familja, malli dhe fëmijët le të të mos pengojnë nga adhurimi All-llahun (s.v.t.). Nëse njëra nga këto ose të trija t’i shkëpusin lidhjet me All-llahun, dije se tërë jeta të ka shkuar kot: **“...Mos t’jua largojnë vëmendjen nga kujtimi i All-llahut as pasuritë dhe as fëmijët tuaj. Dhe kushdo që e bën këtë, atëherë ata janë të humburit.”** (El-Munafikun, 9)

Përkujtimi dhe përmendja e All-llahut të afrojnë te Lartmadhëria e Tij. E kjo wshtja e mundshme vetëm me leximin e Kuranit, të medituarit mbi te, të kuptuarit mirë urdhëresat dhe ndalesat, kryerjen e detyrimeve dhe largimin prej harameve.

MOS U SHOQËRO ME NJERËZ TË KËQIJ!

Në të gjitha veprimet tua mundohu ta zbatosh sunnetin e të Dërguarit të All-llahut! Në asnjë punë tënde mos e kundërshtoj sunetin e të Dërguarit të Zotit! All-llahu thotë: **“Në qoftë se i bindeni atij (të Dërguarit), do të jeni në rrugë të drejtë.”** (En-Nur, 54)

Në çështjen e urdhërimit të së mirës dhe ndalimit nga e keqja ndiqe rrugën e dijetarëve: Në çdo gjë fillo me vetveten! Është urdhëruar Isai (a.s.): **“Së pari këshilloje vetveten!”**

Edukoe veten që të shoqërohesh me njerëzit e mirë dhe të qëndrosh larg të këqia. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Kush i përngjan një populli, ai është prej tyre.”**, **“Njeriu është (dhe do të jetë) bashkë me atë që e do!”**.